



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit “GM Albania” L.L.C., me numër unik identifikues 811365750 dhe seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit G.V., avokat nga Prishtina, kundër debitorit M.D. B.I., i cili operon nën emrin tregtar “Taverna te Osi”, me numër unik identifikues 811451369 dhe seli në Prishtinë, rr. “Bajram Bahtiri”, nr., 81, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit për kthim në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit, si dhe prapësimit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 83/22, i lejuar me datë 08.02.2022, nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori M.D. B.I., numër unik identifikues 811451369 dhe seli në Prishtinë, për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 83/22, i lejuar me datë 08.02.2022, nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi.

- II. HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit M.D. B.I., numër unik identifikues 811451369 dhe seli në Prishtinë, i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 83/22, i lejuar me datë 08.02.2022, nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi, SI I PASAFATSHËM.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën dokumentit noterial, kontratës mbi furnizimin me numër Lrp. Nr. Rend. 6469/21 dhe numër reference 835/21, e datës 11.05.2021, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 83/22, të datës 08.02.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t’ia paguaj shumën e borxhit në lartësi prej EUR 2,000.00, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimor dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim në lartësi prej EUR 156.00.

Debitori, më datë 22.04.2022 ka paraqitur propozim për kthim në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit, me arsyetim se dorëzimi i urdhrin nga

ana e organit përbarues është bërë në mënyrë të parregullt ngase nuk është pranuar nga personi përgjegjës, ndërsa ka shtuar se askund nuk figuron nënshkrimi i debitorit z. M.D. dhe as nënshkrimi i familjarëve të tij. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme ta aprovoj si të bazuar për shkak se dorëzimi nuk është bërë në përputhje me dispozitat e LPK-së, ndërsa debitorit t'i mundësohet që urdhrin ta pranoj në adresën reale ku jeton.

Ndërsa, me datë 27.04.2022, debitori ka paraqitur edhe prapësimin me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përbarimit, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta aprovoj si të bazuar.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se debitori nuk ka ofruar prova në kuptim të nenit 69 të LPP-së, për ti mbështetur pretendimet e tij dhe rrjedhimisht nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e nenit 71 të LPP-së për anulimin e urdhrin përbarimor. Ndërsa, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimin është e pabazuar për shkak si në vijim:

Sipas dispozitës ligjore të nenit 129.1 të Ligjit për Procedurën kontestimore (LPK), parashihet se: *“në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryej veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj të kryej me vonë këtë veprim, po që se konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”*.

Gjykata gjeti se Urdhri për lejimin e përbarimit P.nr. 83/22, i datës 08.02.2022, është dorëzuar me rregull nga ana e organit përbarimor në adresën e debitorit në Prishtinë, rr. “Bajram Bahtiri”, nr. 81, adresë kjo e paraqitur nga debitori në regjistrin zyrtar të bizneseve pranë ARBK-së, dhe se urdhri në fjalë është pranuar me datë 14.02.2022, fakt ky që vërtetohet nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresa të lëndës. Ndërsa, pretendimi se urdhri përbarimor nuk i është dorëzuar personalisht debitorit dhe se askund nuk figuron nënshkrimi i debitorit z. M.D. apo familjarëve të tij është i pabazuar, ngase për dorëzimin e shkresave personave juridik, përfshi këtu edhe shoqërive tregtare të organizuara në formë të biznesit individual, nuk vlejnë rregulltat për dorëzim personal të shkresave nga neni 110 të LPK-së, ngase me nenin 104,

paragrafi 1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u bëhet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalit të punës”*. Andaj, nisur nga fakti se debitori është shoqëri tregtare e organizuar në formë të biznesit individual, rezulton se urdhri përmbartimor mund të dorëzohet edhe tek të punësuarit të cilët gjenden në zyrën gjegjësisht lokalit të debitorit, dhe rrjedhimisht në rastin konkret rezulton se komunikimi me debitorin është zhvilluar konform dispozitave ligjore të LPK-së.

Nisur nga një gjendje e tillë dhe në mungesë të provave të cilat e mbështesin kërkesën e kreditorit për kthim në gjendjen e mëparshme, gjykata vlerëson se arsyet e paraqitura nga debitori në kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, nuk paraqesin shkak të arsyeshëm si rezultat i të cilit debitorit i është pamundësuar ushtrimi i mjetit juridik ndaj urdhrin përmbartimor. Prandaj, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme si të pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe prapësimin e paraqitur nga debitori, mirëpo meqenëse komunikimi me debitorin i datës 14.02.2022 është konsideruar si i rregullt dhe se kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga kreditori rezulton të jetë e pabazuar, ndërsa prapësimi është paraqitur me datë 27.04.2022, gjykata erdhi në përfundim, se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm, kjo pasi që sipas nenit 70 të Ligjit për procedurën përmbartimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”*.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin, 129, 130 dhe nenin 133.4 të LPK-së, lidhur me nenin 68.2 dhe 73.3 të LPP-së, si dhe nenin 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 979/23, datë 30.11.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.